



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

Shkup, 30 dhjetor 2024

Njoftim për shtyp

Ndryshimet më të rëndësishme në borxhin e jashtëm, kërkesat e jashtme dhe pozitën investuese ndërkombëtare: tremujori i tretë i vitit 2024

Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2024, **borxhi i jashtëm bruto** është 11.857 milionë euro dhe shënoi rënie tremujore prej 22 milionë euro. **Kërkesat e jashtme bruto** u rritën për 41 milionë euro dhe arrijnë në 7.425 milionë euro. Rëniatremujore e detyrimeve, njëkohësisht gjatë rritjes së kërkesës solli deri në uljen e **borxhit të jashtëm neto** për 63 milionë euro, kështu që në fund të muajit shtator 2024 është 4.432 milionë euro.

Borxhi i jashtëm dhe pozita investuese ndërkombëtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut

	31.12.2023		30.06.2024		30.09.2024		Ndryshimet tremujore			ndryshimet në krahasim me fundin e vitit të kaluar		
	mill. EUR	% GDP	mill. EUR	% GDP	mill. EUR	% GDP	mill. EUR	%	p.p.	mill. EUR	%	p.p.
Borxhi i jashtëm bruto	11,356.1	77.9	11,879.2	82.0	11,856.7	81.9	-22.4	-0.2	-0.2	500.7	4.4	4.0
Borxhi i jashtëm bruto – Pa përfshirë borxhin e Bankës Qendrore nga marrëveshjet repo	10,990.4	75.4	11,394.5	78.7	11,464.8	79.2	70.3	0.6	0.5	474.4	4.3	3.8
Borxh afatgjatë	8,498.4	58.3	8,659.5	59.8	8,687.1	60.0	27.7	0.3	0.2	188.7	2.2	1.7
Borxh afatshkurtër	2,857.6	19.6	3,219.7	22.2	3,169.6	21.9	-50.1	-1.6	-0.3	311.9	10.9	2.3
Borxh afatshkurtër pa repo	2,492.0	17.1	2,735.0	18.9	2,777.7	19.2	42.6	1.6	0.3	285.7	11.5	2.1
Borxhi publik pa repo	5,577.9	38.2	5,731.4	39.6	5,520.9	38.1	-210.4	-3.7	-1.5	-57.0	-1.0	-0.1
Borxhi publik pa repo	5,212.3	35.7	5,246.7	36.2	5,129.0	35.4	-117.7	-2.2	-0.8	-83.3	-1.6	-0.3
Borxhi privat	5,778.1	39.6	6,147.8	42.4	6,335.8	43.7	188.0	3.1	1.3	557.7	9.7	4.1
Kërkesat e jashtme bruto	6,989.5	47.9	7,383.8	51.0	7,424.7	51.3	41.0	0.6	0.3	435.3	6.2	3.3
Kërkesat e Bankës Qendrore nga marrëveshjet e anasjellta repo	6,989.3	47.9	7,141.0	49.3	7,236.5	50.0	95.5	1.3	0.7	247.2	3.5	2.0
Borxhi i Jashtëm Neto	4,366.6	29.9	4,495.4	31.0	4,432.0	30.6	-63.4	-1.4	-0.4	65.4	1.5	0.7
Borxhi i Jashtëm Neto pa repo	4,001.1	27.4	4,253.5	29.4	4,228.4	29.2	-25.2	-0.6	-0.2	227.2	5.7	1.8
PIN¹ neto	-8,311.3	-57.0	-8,636.3	-59.6	-8,544.4	-59.0	91.9	-1.1	0.6	-233.1	2.8	-2.0

* /Të dhënat për prodhimin e brendshëm bruto (PBB) për vitin 2023 është vlerësim paraprak (burimi: Enti shtetëror për Statistikë, njoftimi "Prodhimi i brendshëm bruto, tremujori e tretë 2024" prej datës 6.12.2024). Të dhënat për vitin 2024 janë parashikimet e BPRMV-së (tetor, viti 2024).
Burimi: BPRMV, EShS.

Pozita **negative e investimeve ndërkombëtare neto**¹, në fund të muajit shtator 2024 është 8.544 milionë euro, ose 59% e PBB-së² së projektuar për vitin 2024. Nga kjo shumë, pjesa më e madhe, ose 92%, e përbëjnë detyrimet neto të bazuara në investime direkte, nga të cilat 69% janë në bazë të kapitalit vetanak.

Borxhi i jashtëm bruto

Në fund të muajit shtator të vitit 2024, borxhi i jashtëm bruto është 11.857 milionë euro (ose 81,9% nga PBB-ja e projektuar) dhe shënon rënie tremujore prej 22 milionë euro (ose për 0,2%).


¹ Pozita investuese ndërkombëtare (PIN) është raport statistikor që tregon gjendjen e mjeteve dhe detyrimeve financiare të jashtme të Republikës së Maqedonisë së Veriut në një datë të caktuar, d.m.th. kërkesat dhe detyrimet ndaj jorezidentëve bazuar në instrumente financiare. Për më tepër, pozita negative e investimeve ndërkombëtare neto do të thotë se detyrimet financiare tejkalojnë kërkesat financiare nga jorezidentët.

² Të dhënat për PBB-në për vitin 2024 janë projektim i BPRMV-së (tetor, 2024).




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

Nëse nga borxhi përjashtohet ndikimi i aktiviteteve specifike për menaxhimin e rezervave valutore të bankës qendrore³, borxhi bruto shënoi rritje tremujore prej 70 milionë euro. Ky ndryshim tremujor është rezultat i rritjes së borxhit privat (për 188 milionë euro), gjatë uljes së detyrimeve në borxhin publik (për 118 milionë euro). Rritja e borxhit privat vjen si pasojë e rritjes së borxhit të subjekteve kapitale të lidhura (për 223 milionë euro), me rënien e borxheve në bankat private (për 32 milionë euro) dhe në sektorin privat jobankar (për 3 milionë euro). Ulja tremujore e borxhit të jashtëm publik prej 118 milionë euro është rezultat i uljes së borxhit të sektorit "shtetëror" (për 70 milionë euro), në bankat publike dhe ndërmarrjeve publike (për 45 milionë euro) dhe në bankën qendrore (për 3 milionë euro).



Burimi: BPRMV, EShS.



Krahasuar me fundin e vitit 2023, borxhi i jashtëm bruto është më i lartë për 501 milionë euro, ose për 4,4%. Ndërkaq, borxhi me efekt të përjashtuar nga aktivitetet specifike për menaxhimin e rezervave valutore të bankës qendrore është rritur me 474 milionë euro. Rritja e arritur është rezultat i rritjes së borxhit të jashtëm privat (për 558 milionë euro), gjatë uljes së borxhit publik (për 83 milionë euro). Në borxhin privat, rritje është vërejtur tek subjektet e lidhura me kapitalin (për 543 milionë euro) dhe sektori privat jobankar (për 176 milionë euro), ndërsa borxhi i bankave private është ulur (për 161 milionë euro). Në lidhje me borxhin publik, ulja është rezultat i uljes së detyrimeve në sektorin "shtetëror" (për 57 milionë euro) dhe i bankave publike dhe dhe ndërmarrjeve publike (për 27 milionë euro), në kushte të rritjes së detyrimeve në bankat qendrore (për 1 milionë euro).

Kërkesat e jashtme bruto

Kërkesat e jashtme bruto, në fund të tremujorit të tretë të vitit 2024, arrijnë 7.425 milionë euro (për 51,3% nga PBB-ja e projektuar) dhe vërejtën rritje tremujore prej 41 milionë euro (ose për


³ Aktivitetet specifike për menaxhimin e rezervave valutore të bankës qendrore i referohen marrëveshjeve repo dhe operacioneve të tjera që lidhen me menaxhimin e rezervave valutore. Me rastin e përfundimit të këtyre transaksioneve krijohen detyrime (të klasifikuara në kategorinë "kredi") që kontribuojnë në rritjen e nivelit të borxhit bruto. Në të njëjtën kohë, gjatë përfundimit të këtyre transaksioneve në drejtim të kundërt, të kërkesat e krijuara kontribuojnë në rritjen e kërkesave bruto. Të marra në tërësi, këto transaksione kanë një efekt neutral në bazën neto nëse ato kryhen njëkohësisht në të njëjtën shumë. Nëse transaksionet e kryera nuk janë me shumë identike në të dy drejtimet, ato kanë ndikim në borxhin e jashtëm bruto dhe neto dhe në të kërkesat bruto.




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

0,6%). Nëse përjashtohet ndikimi i aktiviteteve specifike të bankës qendrore lidhur me menaxhimin e rezervave valutore, kërkesat e jashtme bruto janë rritur për 95 milionë euro dhe arrijnë 7.236 milionë euro. Ky ndryshim tremujor është rezultat i rritjes së kërkesave private për 71 milionë euro dhe rritje të kërkesave publike për 25 milionë euro. Rritja tremujore e kërkesave të jashtme në sektorin privat është rezultat i rritjes së kërkesave të institucioneve depozituese (për 55 milionë euro), të subjekteve të lidhura me kapitalin (për 12 milionë euro) dhe sektorëve të tjerë (për 4 milionë euro). Rritja e kërkesave publike vjen si pasojë e rritjes së kërkesave të bankës qendrore.

Krahasuar me fundin e vitit të kaluar, kërkesat e jashtme bruto janë më të larta për 435 milionë euro. Pa efektin e aktiviteteve specifike për menaxhimin e rezervave valutore të bankës qendrore, kërkesat e jashtme bruto u rritën për 247 milionë euro, kjo si rezultat i rritjes së kërkesave private (për 492 milionë euro), me kërkesa të ulura publike (për 245 milionë euro). Rritja e kërkesave private rezulton nga rritja e kërkesave të subjekteve të lidhura me kapitalin (për 328 milionë euro) dhe sektorëve të tjerë (për 179 milionë euro), me rënie të kërkesave të institucioneve depozituese (për 15 milionë euro).



Burimi: BPRMV, EShs.





Borxhi i jashtëm neto

Më 30.9.2024, borxhi i jashtëm neto është 4.432 milionë euro (ose 30,6% nga PBB-ja e projektuar). Borxhi i jashtëm neto i vendit, në tremujorin e tretë të vitit 2024, është ulur për 63 milionë euro, ose për 1,4%. Për sa i përket strukturës, borxhi privat neto vazhdon të ketë pjesëmarrjen më të madhe në totalin e borxhit neto prej 67%.

Në lidhje me fundin e vitit 2023, borxhi i jashtëm neto është rritur për 65 milionë euro (ose 1,5%), në kushtet e rritjes së borxhit privat neto (për 66 milionë euro) dhe ulje të borxhit publik neto (për 1 milionë euro).



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës



Burimi: BPRMV, EShS.

Pozita investuese ndërkombëtare, neto

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024, pozicioni negativ i investimeve ndërkombëtare neto (PIN) është ulur për 92 milionë euro dhe është 8.544 milionë euro, që paraqet 59% nga PBB-ja e parashikuar për vitin 2024.

Rënia tremujore e PIN-it negativ, neto, rezulton nga rritja më intensive e mjeteve (për 123 milionë euro), në raport të rritjes së detyrimeve (për 31 milionë euro). Parë nga instrumentet, detyrimet neto të bazuara në instrumentet e borxhit janë për 63 milionë euro, ndërsa detyrimet neto të bazuara në instrumente vetanake shënuan rritje për 28 milionë euro.

Në krahasim me fundin e vitit 2023, PIN-i negativ, neto, është rritur për 233 milionë euro, si rezultat i rritjes së detyrimeve neto bazuar në instrumentet vetanake (për 168 milionë euro) dhe instrumentet e borxhit (për 65 milionë euro).




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

Pozita investuese ndërkombëtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut


(në milionë euro)

PIN, sipas instrumenteve	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	T1 2023	T2 2023	T3 2023	T4 2023	T1 2024	T2 2024	T3 2024
Pozicioni i Investimeve Ndërkombëtare neto	-5,082.7	-5,576.0	-5,822.5	-6,039.5	-6,458.4	-6,900.6	-7,244.9	-8,129.2	-8,016.0	-8,195.7	-8,083.1	-8,311.3	-8,446.9	-8,636.3	-8,544.4
Mjetet	4,571.9	5,171.3	5,157.3	5,913.6	6,163.8	6,172.5	7,041.4	7,666.7	8,123.5	8,355.6	8,234.8	8,375.8	8,936.3	8,950.6	9,073.9
Investimet direkte	655.0	811.9	967.6	896.2	936.8	784.3	915.5	1,014.8	1,215.3	1,323.5	1,476.5	1,042.0	1,381.7	1,371.2	1,392.9
Investimet e portofolit	212.6	255.2	300.2	321.2	406.1	470.9	650.0	695.3	736.3	778.8	810.7	917.0	947.2	980.5	1,033.7
Derivatet financiare (përveç rezervave) dhe opsonet e aksioneve të punonjësve	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Kapitalet tjera	1.0	1.2	2.8	2.9	4.4	4.5	6.0	6.0	5.9	5.9	5.8	5.8	6.0	5.7	5.7
Valuta dhe depozitat	615.4	627.3	635.5	694.0	580.0	562.9	657.6	653.5	561.9	604.7	676.5	650.9	611.7	613.3	644.6
Kreditë	67.1	52.1	56.1	74.5	79.1	87.3	125.9	221.6	154.6	158.5	187.9	74.7	433.8	326.3	273.2
Sigurimet, pensionet dhe skemat e standardizuara garancie	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Kreditë tregtare dhe avanset	757.4	809.6	858.8	1,057.2	894.4	902.3	1,042.3	1,212.4	1,290.0	1,294.0	1,175.2	1,146.5	1,268.5	1,315.1	1,316.4
Llogari tjera të arkëtueshme/pagueshme	1.7	0.5	0.1	0.5	0.3	0.4	0.9	0.3	0.2	0.4	0.5	0.6	0.3	0.9	0.9
Aktive reserve	2,261.8	2,613.4	2,336.3	2,867.1	3,262.6	3,359.9	3,643.3	3,862.9	4,159.2	4,189.7	3,901.7	4,538.4	4,287.1	4,337.5	4,406.6
Detyrimet	9,654.6	10,747.3	10,979.8	11,953.0	12,622.2	13,073.1	14,286.3	15,795.9	16,139.5	16,551.2	16,317.9	16,687.2	17,383.2	17,587.0	17,618.3
Investimet direkte	4,951.3	5,392.2	5,598.1	6,141.3	6,580.0	6,537.1	7,089.2	7,853.6	8,112.9	8,298.8	8,440.1	8,281.5	8,758.4	8,981.5	9,258.0
Investimet e portofolit	848.8	1,362.2	1,476.3	1,813.2	1,730.7	2,103.8	2,159.2	2,106.7	2,564.5	2,592.2	2,227.4	2,323.0	2,210.0	2,184.3	2,148.4
Derivatet financiare (përveç rezervave) dhe opsonet e aksioneve të punonjësve	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Kapitalet tjera	4.3	6.0	2.3	4.2	4.0	5.0	2.7	3.3	5.5	7.7	9.9	12.1	13.6	14.1	17.4
Valuta dhe depozitat	148.5	174.2	195.2	206.2	254.2	253.3	297.3	471.0	363.4	398.9	300.1	462.0	335.4	349.5	316.7
Kreditë	2,961.7	3,014.7	2,872.0	2,883.4	3,100.9	3,267.2	3,580.3	4,043.3	3,790.7	3,944.0	4,005.8	4,257.3	4,629.3	4,572.1	4,421.8
Sigurimet, pensionet dhe skemat e standardizuara garancie	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Kreditë tregtare dhe avanset	656.7	714.6	757.7	824.8	871.1	827.8	910.3	1,062.6	1,054.0	1,064.7	1,085.4	1,107.1	1,189.3	1,237.7	1,211.2
Llogari tjera të arkëtueshme/pagueshme	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	1.4	0.0	5.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Të drejta të veçanta të arkëtimit (indja e detyrimeve neto)	83.2	83.2	78.2	79.8	81.3	77.4	247.3	250.5	248.5	244.8	249.2	244.2	247.2	247.8	244.8

Burimi: BPRMV.



Burimi: BPRMV, EShS.



Rishikimet e të dhënave

Të dhënat mbi borxhin e jashtëm bruto dhe kërkesat në këtë publikim përmbajnë rishikime të rregullta të të dhënave për periudhën janar - qershor 2024. Ndryshimet në borxhin e jashtëm bruto dhe të kërkesat rezultojnë nga mbulimi më i mirë i të dhënave për kreditë dhe kreditë tregtare dhe paradhëniet. Nga këndvështrimi i kahut të ndryshimeve, në tremujorin e parë dhe të dytë të vitit 2024, rishikimi i të dhënave çoi në rritje të borxhit të jashtëm bruto (për 21,3, respektivisht 4,2 milionë euro), ndërkohë që kërkesat e jashtme bruto janë rritur në tremujorin e parë (për 11,6 milionë euro), ndërsa janë ulur në tremujorin e dytë (për 10,2 milionë euro). Njëkohësisht, këto ndryshime janë reflektuar edhe në borxhin e jashtëm neto, por edhe te PIN-i, neto, në tremujorin e parë të vitit 2024 të tilla si rritja e borxhit të jashtëm neto dhe PIN-i neto



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

negativ më i lartë (për nga respektivisht 9,7 milionë euro), ndërsa në tremujorin e dytë të vitit 2024 të tilla si rritja e borxhit të jashtëm neto dhe PIN-i neto negativ më i lartë (për 14,4 milionë euro, respektivisht 13,9 milionë euro).

Informacione mbështetëse

Të dhënat të serive kohore - të dhëna vjetore dhe tremujore për borxhin e jashtëm bruto dhe kërkesat e jashtme bruto:

https://www.nbrm.mk/nadvoresen_dolg-al.nspix

Të dhënat të serive kohore - të dhëna vjetore dhe tremujore për pozitën e investimeve ndërkombëtare:

https://www.nbrm.mk/megunarodna_investiciska_pozicija-al.nspix

Shpjegime metodologjike mbi borxhin e jashtëm bruto dhe kërkesat:

http://nbrm.mk/content/statistika/ND/metodologija/Metodologija_nadvoresen_dolg_5_2_2018.pdf

Shpjegime metodologjike për pozitën e investimit ndërkombëtar:

http://nbrm.mk/content/statistika/mip/metodologija/Metodologija_MIP_BPM6_9_10_2018.pdf

Publikimet e ardhshme: Kalendar i publikimit të të dhënave:

https://www.nbrm.mk/kalendar_na_objavuvanje_na_podatoci-al.nspix

Borxhi i jashtëm bruto tremujor, kërkesat e jashtme bruto dhe pozita e investimeve ndërkombëtare: 26 mars 2024 (seksioni i referencës që nga shtatori 2024).

Për pyetje nga mediat, ju lutemi kontaktoni personat përgjegjës nga Kabineti i Guvernatorit.

Për informata më të detajuara lidhur me të dhënat statistikore të publikuara, mund të na kontaktoni në contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin telefonik 02 3215 181 lokali 103 (ose 110/108).